

S T A T U T

1

SHOQËRISË "LULI" SH P K:

Neni 1

Shoqëria "LULI" shpk Tiranë, krijohet në mbështetje të ligjit Nr. 763 dt. 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe në zbatimin e tij harton këtë statut.

Neni 2

Shoqëria mbështetur në aktin e themelimit të saj, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe emërtimi i saj i plotë - Shoqëria "LULI" shpk Tiranë.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është :

1. Import-eksport për tregtimin e materialeve të ndërtimit në përgjithësi me shumicë dhe pakicë, si dhe tregtimin e të gjithë llojeve të materialeve hidro sanitare.

Neni 4

Shoqëria "LULI" shpk e ka selinë e saj në qytetin e Tiranës, në banesën e tij, me numër telefoni 21749. Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nisur nga nevojat e saj, shoqëria mundet të hapi degët e saj në të gjithë territorin e republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Neni 5

Shoqëria do të fillojë veprimtarinë e saj pas rregjistrimit në rregjistrin tregtar të gjykatës së rrethit të Tiranës dhe do të vazhdojë këtë veprimtari deri më 31.12.2020.

Shoqëria mundet të vazhdojë veprimtarinë e saj dhe pas kalimit të këtij afati, mbështetur në dispozitat ligjore në fuqi dhe në marrëveshje me ortakët.

Neni 6

Shoqëria "LULI" shpk është person juridik privat me përgjegjësi të kufizuar dhe ushtron veprimtarinë e saj mbi bazën e ortakërisë.

Veprimtaria territoriale e saj shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij.

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000(njëqindmijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në kuota të barabarta dhe është i rregjistruar në librin e ortakëve.

Neni 8

Kapitali themeltar është i ndarë në pjesë të barabarta në kuota 50(pesëdhjetë) %. Cdo ortak përfaqësohet sipas kontributit të dhënë në kapitalin fillestar, ku ka të drejtën e një vote për kuota.

Ortakët janë titullar të së drejtës në zgjedhjen e kuotave të reja, që rezultojn si pasoj e rritjes së kapitalit të shoqris.

Trasferimi ose shitja e kotave bëhet me vendimin e asambles së ortakëve që është organi legal i shoqris. Në qoftë se njiri nga ortakët do të transferoj pjesën e tij të kapitalit themeltar tek të tretët, që nuk bëjnë pjes në shoqri, projektin e tij të transferimit duhet tja njoftoj me shkrim shoqris dhe, secilit prej ortakëve.

Në qoftë se nuk e bënë të ditur vendimin e saj brenda tremujave nga data e venjes në dijeni, transferimi i pjesës së kapitalit konsiderohet i miratuar. Secili ortak është i lirë të transferojë pjesën e tij të kapitalit themeltar tek ortakët, ose tek secili prej ortakëve.

Neni 9

Secilit ortak i lind e drejta të shkëputet nga veprimtaria e shoqërisë. Ai që shkëputet duhet që kuotat e tij tja afrojë ortakëve të tjerë për blerje. Në rast se shoqëria nuk pranon ti bëjë këto kuota brenda tre muajve, atëherë atij i lind e drejta ti shesë ato tek të tretët, por jo me cmime më të ulta se ato që janë afruar më parë shoqërisë.

Neni 10

Të ardhurat e shoqërisë vlerësohen në bilancin e saj, në lek e valutë, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor. Bilanci vjetor i shoqërisë paraqitet brenda tre muajve të vitit që pason. Fitimi neto që rezulton nga bilanci ndahet si më poshtë:

- a- 5 (pesë) % rezervz legale e shoqërisë.
- b- 25 (njëzetepesë) % për zgjerimin e kapitalit.
- c- 70 (shtatëdhjetë) % midis ortakëve.

Neni 11

Organi vendimor i shoqërisë është ansamblea e ortakëve e cila mbli-dhet jo më pak se një herë në muaj. Ansamblea vendos për bilancin vjetor ndryshimet në statut, zgjedhjen e administratorit, për strukturën organizative, ekspertët kontabël dhe për krijimin e organizimin e degëve të shoqërisë.

Neni 12

Vendimet për veprimtarinë e shoqërisë merren nga ansamblea. Ato merren vetëm pas konsultimit me shkrim të ortakëve dhe pasi ato kanë miratuar me shkrim përmbajtjen e konsultimit. Ortakët përmbledhjen e asamblesë njoftohen me shkrim dhjetë ditë përpara, ku përfshihet dhe rendi i ditës i mbledhjes. Lajmërimi për mbledhje bëhet nga administratori. Mbledhja e asamblesë mundet të kërkohet dhe nga ortakët që përfaqësojnë dhjetë përqind të kapitalit themeltar.

Neni 13

Neni 13

Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendimet dhe disponon numrin e votave të barabarta me kuotat që zotëron në kontributin e dhënë në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Secili ortak mundet të përfaqësojë ose të përfaqësohet në mbledhjen e asamblesë nga një ortak tjetër.

Neni 14

Në mbledhjen e asamblesë ose me konsultime me shkrim, vendimet merren nga ortakët që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kuotave, të kontributit në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 15

Secili ortak ka të drejtë të shtojë pjesën e tij të kapitalit me anë të kontributit në para, duke i bërë kërkesë sipas dispozitave ligjore në fuqi asamblesë të ortakëve pas mbarimit të mbylljes së vitit financiar.

Neni 16

Cdo ortak që nuk është administrator ka të drejtë dy herë në vit të paraqesë me shkrim administratorit pyetjet që kanë të bëjnë me atë problem që vë në dyshim veprimtarinë e shoqërisë.

Përgjigja e administratorit i komunikohet; ortakut në mbledhjen e zakonshme të asamblesë ku merr pjesë dhe ekspertit kontabël.

Neni 17

Shoqëria administrëhet nga një administrator që zgjidhet nga gjiri i ortakëve me votim të fshehtë dhe me votat e ortakëve që disponojnë më tepër se gjysma e kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Administratori zgjidhet për një periudhë kohe një vjecare, por asamblea mundet të rinovojë mandatin e tij për: cdo vit.

Neni 18

Administratori ka këto kompetenca:

- Realizimin e planeve dhe llogarive të shoqërisë.
- Organizon përdorimin e kapitalit të shoqërisë, me miratim të asamblesë së ortakëve.
- Vendos për marrjen e huave dhe financimeve nga të tretët, të cilat do të përdoren për zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë.
- Kontrollon veprimtarinë e strukturave të shoqërisë, vendos për organikën pagën dhe shpërblimet.
- Harton rregulloren e punës dhe të drejtimit të shoqërisë e të: degëve të saj.
- Harton kontratën kolektive dhe individuale të punës dhe kontrollon zbatimin e tyre.
- Pëson shoqërinë në marrëdhënie

- Përfaqëson shoqërinë në mbledhje (marrëdhënie) me të tretët dhe në organet gjyqësore ose të arbitrazheve.

Mënskhkruan kontrata ose marrëveshje në emër të shoqërisë dhe siguron zbatimin e tyre, zgjidh mosmarrëveshje që mund të lindin nga zbatimi i këtyre kontratave ose marrëveshjeve.

Neni 19

Administratori në mandatin e tij ka këto kufizime:

Nuk mund të ushtrojë kompetenca që ligja dhe ky statut ju jep ortakëve. Nuk mund të lidhi kontrata ose marrëveshje që tejkalojnë objektin e veprimtarisë së shoqërisë. Administratori përgjigjet civilisht për dëmet e shkaktuara shoqërisë, që rezultojnë nga tejkalimi i kompetencave të tij

-Neni 20

Administratori mundet të shkarkohet nga detyra dhe para mbarimit të mandatit të tij. Ky shkarkim bëhet me vendim të asamblesë me votat e ortakëve që përfaqësojnë më tepër se gjysma e kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë. Administratori mund të shkarkohet nga detyra me vendim të gjykatës për shkelje të ligjit, me kërkesë të çdo njërit prej ortakëve.

Neni 21

Ortakët zgjedhin në mbledhjen e parë të asamblesë ekspertin kontabël, të cilët përgatisin për asamblenë e ortakëve raportin e ekspertimit financiar. Ekspertët kontabël zgjidhen nga asamblea për një periudhë kohe pesë vjecare. Për kryerjen e kësaj detyre duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga ligji.

Ekspertët kontabël gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre mundet të zevendësohen vetëm pas mbarimit të vitit financiar dhe pasi të ketë mbaruar mbledhja e zakonshme e asamblesë e ortakëve; që ka marrë vendimin për llogaritë vjetore.

Neni 22

Më mbarimin e vitit financiar, administratori ka të drejtë të paraqesi asamblesë së ortakëve propozimin zyrtar për shndërrimin e shoqërisë, mbarimin e saj dhe gjithnjë duke u mbështetur në dispozitat ligjore në fuqi, propozon dhe anëtarët e komisionit të likuidimit. Për marrjen e vendimit për kërkesën e mësipërme është i detyrueshëm miratimi i ortakëve që përfaqësojnë tre të katërtën e kontributit themeltar.

Neni 23

Për të gjitha marrëveshjet ose probleme të tjera që mundet të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë për të cilat zgjidhja e tyre nuk parashikohet në këtë statut, referimi do të bëhet në dispozitat e ligjit për shoqëritë tregtare dhe në dispozitat e tjera në fuqi.

ORTAKËT

1. Mark Luli
2. Sanije Shtufi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
Noteria Durrës

Nr.Rep. 494 Nr.Kol 93

V Ë R T E T I M

Sot me dt. 05.08.1997 (pesë gusht njëmijënjëntëqindënjëntëdhjetështatë) ditë e martë, para meje, noteri LLia Kona u paraqitën personalisht të lartë përmendurit , identitetin e të cilëve e sigurova nga letër njoftimet përkatëse, madhor, me zotësinë të plotë juridike për të vepruar, të cilët më deklaruan sa më sipër se është shprehje e vullnetit të lirë të tyre dhe pasi e lexuan e firmosën pa vrejtje. Unë noterja e vërtetova atë_____.

N O T E R E

LLia Kona



Shënim: Çulla e Jakes, 10 lë,
dhe me ligjin malin
100 lë